

Çfarë është Linja e Ndhmës për Shëndetin Mendor?

Linja e Ndhmës për Shëndetin Mendor (BHHL) lidh individët dhe familjet me gamën e plotë të shërbimeve trajtuese për shëndetin mendor dhe problemeve me përdorimin e substancave në Massachusetts, përfshi pacientët jo të shtruar dhe kujdesin urgjent dhe të menjëhershëm në raste krizash. Kontakto për mbështetje në kohë reale, vlerësim fillestar klinik dhe për t'u lidhur me ofruesin e vlerësimit dhe trajtimit të duhur.

Si funksionon?

BHHL është e disponueshme 24 orë në ditë, 365 ditë në vit, me telefonata dhe mesazh me tekst në numrin 833-773-2445 (BHHL), si edhe me chat online në masshelpline.com.

Kush përgjigjet kur unë kontaktoj BHHL?

Personeli i BHHL janë specialistë mjekësorë të trajnuar dhe persona që kanë përjetuar të njëjtat probleme të certifikuar për të ofruar mbështetje për të gjitha nevojat e personave që kontaktojnë. Çdo bisedë me telefonatë, mesazh me tekst apo chat përfshin monitorimin nga specialistë mjekësorë të trajnuar dhe stafi do të qëndrojë në linjë derisa të jeni lidhur me shërbimin që jep ndihmën për të cilën keni nevojë.

Kush mund ta përdorë BHHL?

Kushdo! BHHL është për këdo në Massachusetts, përfshi LGBTQIA+, Zezakët, Indigjenët dhe Njerëzit me Ngjyrë (BIPOC), individë që janë të shurdhër apo kanë probleme me dëgjimin, dhe individë gjuha e parë e të cilëve nuk është anglishtja.

A mund të kontaktoj nëse nuk flas anglisht?

BHHL është e disponueshme në më shumë se 200 gjuhë. Individë që janë të shurdhër apo që kanë vështirësi me dëgjimin mund të kontaktojnë MassRelay në numrin 711.

Sa kushton, dhe a duhet të kem siguracion shëndetësor?

BHHL është falas dhe në dispozicion të të gjithë rezidentëve të Massachusetts, edhe nëse nuk ke siguracion.

Nëse jam i shqetësuar për fëmijën tim apo një shok, a mund të kontaktoj për të marrë ndihmë për ta?

Po – mund të kontaktosh për të marrë ndihmë për veten apo për dikë të dashur, përfshi fëmijët dhe anëtarë të tjerë të familjes.

Kam provuar më parë të marr ndihmë dhe nuk funksionoi. Si është kjo ndryshe?

Një anëtar i trajnuar dhe i kujdesshëm i personelit do të punojë me ju për të identifikuar trajtimin që mund t'ju ndihmojë dhe do t'ju ndihmojë të navigoni përgjatë procesit. Ata do të rrinë në linjë me ju derisa të jeni lidhur me shërbimin që ofron ndihmën që u përgjigjet më mirë nevojave tuaja dhe do t'ju kontaktojnë më pas për të siguruar që të gjitha nevojat tuaja po plotësohen.

A do të mundem t'i marr shërbimet apo trajtimin në komunitetin tim?

Po. BHHL lidh njerëzit me trajtimin në komunitetin e tyre, përfshi 25 Qendrat Komunitare për Shëndetin Mendor në të gjithë shtetin. BHHL bashkëpunon me të gjithë ofruesit e trajtimit për shëndetin mendor dhe problemet me përdorimin e substancave.

Për çfarë lloj problemesh të shëndetit mendor mund të kontaktoj?

BHHL mund të ndihmojë me çdo shqetësim që lidhet me shëndetin mendor. Ndoshta jeni i trishtuar, në ankth apo i shqetësuar në lidhje me përdorimin e drogave apo alkoolit. Edhe nëse nuk jeni i sigurt se cili është problemi apo se për çfarë lloj ndihme keni nevojë, personeli i BHHL do t'ju dëgjojë dhe do t'ju lidhë me ofruesin e duhur të kujdesit për veten apo një njeriun tuaj të dashur.

Në rast krize të shëndetit mendor, duhet të shkoj te emergjencat apo të kontaktoj me BHHL?

BHHL është e disponueshme 24/7 për këdo që po përjeton një krizë të shëndetit mendor dhe mund t'ju lidhë drejtpërdrejt me një qendër që ofron mbështetje në komunitetin tuaj. Nëse ka probleme sigurie që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, BHHL e lidh personin që ka kontaktuar me 911. Mundeni edhe të vizitoni një Qendër Komunitare për Shëndetin Mendor në zonën tuaj për ndërhyrje në rast krize.

Ku mund të gjej më shumë informacione?

Vizitoni [Masshelpline.com](https://www.masshelpline.com)

Mundeni edhe të skanoni kodin QR për një Listë të Qendrave Komunitare për Shëndetin

